

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Harry dhe Meghan ndryshojnë shkollën e fëmijëve pas dy ditësh për shkak të shqetësimeve të sigurisë
ADRESA	https://albeu.com/lajme/bota/harry-dhe-meghan-ndryshojne-shkollen-e-femijeve-pas-dy-dite-sh-per-shkak-te-shqetesimeve-te-sigurise/1011704/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 20:23:31 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 20:19:46 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	67c62c015c93b312da19b30185fee208a8ede3304cf2de83432a37da9ecd9c3c
TEKSTI	7fb47499497fbd83d8e23ac9e1a5bc31f1cca9c981e73885140b658112c034dd
PAMJA	ddf865e3b42a427e2263c1202774bc37dc842c91f3d532149c8386223a2eea59

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	119202d8ae53d39cb9c307f9af55763303e15da741c62956b8a38bac027e36ba
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	49912a82e108233a2f4c1eb29c0feee4310e444550233db1ec41850f1c69f554
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/119202d8ae53d39cb9c307f9af55763303e15da741c62956b8a38bac027e36ba>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Harry dhe Meghan ndryshojnë shkollën e fëmijëve pas dy ditësh për shkak të shqetësimeve të sigurisë



Princi Harry dhe Meghan Markle kanë vendosur të largojnë fëmijët e tyre, Princin Archie dhe Princeshën Lilibet, nga shkolla e re britanike ku kishin nisur të ndiqnin mësimet vetëm dy ditë më parë, raportoi ITV News.

Archie, shtatë vjeç, dhe Lilibet, pesë vjeç, ishin regjistruar në një shkollë përgatitore në Britani pas zhvendosjes së familjes nga Shtetet e Bashkuara në Mbretërinë e Bashkuar, pas disa vitesh qëndrimi atje. Sipas raportimeve, fëmijët "po fillojnë diku në një shkollë tjetër".

Vendimi dyshohet se lidhet me çështje sigurie. Çifti ka zhvilluar diskutime me ekipin e tij të mbrojtjes për rreziqet e mundshme që mund të kërcënojnë fëmijët.



Zhvillimi ndodh ndërsa autoritetet po rivlerësojnë masat e sigurisë për Harry-n dhe Meghan-in gjatë kohës që ata ndodhen në Britani.

të fundit /



Harry dhe Meghan ndryshojnë shkollën e fëmijëve pas dy ditësh...



China Zorrilla", trakti elektrik më i madh në botë mbërrin në...



Kodi Zgjedhor rikthehet në tryezën e diskutimeve në...



Maqedonia e Veriut rikthehet në Eurovision në vitin 2027 pas pesë...



Pas aksidentit dhe akuzave për drogë, Daniel Maldini publik...



Mërgim Lushtaku: Kosova duhet të jetë e gatshme të mbrojtë...



Kusari-Lila pas tërheqjes së Sejdiut: Pa marrëveshje për...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Ravec, komiteti i Ministrisë së Brendshme britanike që shqyrton sigurinë e anëtarëve të familjes mbretërore dhe personave të tjerë me profil të lartë, thuhet se e ka njoftuar Princin Harry për një vlerësim të plotë të rrezikut ndaj tij dhe familjes së tij.

Korrespondenti mbretëror i ITV News, Chris Ship, tha se shqyrtimi u vendos pasi Harry është tashmë banor në vendin ku ka lindur dhe fëmijët e tij kishin filluar shkollën në Britani.



Ky proces përbën një zhvillim të rëndësishëm për familjen, pasi rreziku ndaj Meghan nuk ishte analizuar në këtë nivel që prej vitit 2020, kur çifti u tërhoq nga detyrat si anëtarë të familjes mbretërore.

Prej vitesh, Harry është përfshirë në një përballje gjyqësore me Ministrinë e Brendshme britanike lidhur me mbrojtjen e tij. Pas largimit nga detyrat mbretërore dhe vendosjes në Kaliforni, atij iu hoq e drejta për siguri policore të financuar nga taksapaguesit.

Duka i Sussex-it ka këmbëngulur se pozita e tij si djali i mbretit britanik, i pesti në radhën e trashëgimisë së fronit dhe veteran i ushtrisë britanike, e bën të nevojshme mbrojtjen policore gjatë qëndrimit në Mbretërinë e Bashkuar.

Pas humbjes së mëparshme në gjykatë, Harry i kishte thënë BBC-së se nuk e përfytyronte dot një moment kur do të mund ta sillte familjen e tij në Britani në kushte të sigurta.

Me rikthimin e Harry-t, Meghan-it dhe fëmijëve për të jetuar në Mbretërinë e Bashkuar, siguria e familjes është bërë sërish një çështje qendrore.

Sipas ITV News, aktualisht Sussex-ët kanë vetëm numrin e telefonit të një oficeri ndërlidhës të policisë britanike, të cilin mund ta telefonojnë në rast nevojë. Harry mendon se kjo masë nuk mjafton për përballimin e një kërcënimi të menjëhershëm.

Familja shpenzon miliona për siguri private, por truporjat e Harry-t dhe Meghan-it nuk lejohen të mbajnë armë në Britani, ndryshe nga disa rregulla në fuqi në Shtetet e Bashkuara.

Scotland Yard nuk jep të dhëna për masat konkrete të sigurisë që lidhen me familjen mbretërore. Ndërkohë, burime të cituara nga mediat britanike bëjnë të ditur se niveli i mbrojtjes përcaktohet sipas rastit dhe rishikohet në mënyrë të vazhdueshme.

Ministria e Brendshme britanike dhe përfaqësuesit e Sussex-ëve janë kontaktuar për një reagim mbi këto zhvillime, por deri tani nuk kanë dhënë koment.



China Zorrilla", trageti elektrik më i madh në botë mbërrin në Uruguai dhe n...



Rrëzohet një avion privat në Gjermani, humbin jetën tre persona



Pas protestave në Serbi, Vučić njofton dorëheqjen: Do të largohem më 27...



Mes brirëve të demit 540 kilogramësh për mbi 10 sekonda, Roca Rey...



Trump kundër ngadalësimit të AI-së: SHBA duhet të ruajë epërsinë ndaj Kinës



Avioni privat i nisur nga Holanda përplasët në një fushë në Gjermani, humb...



The Guardian": Azilkërkuesit e kthyer nga Britania në Francë...



Sistemi EES për kontrollet kufitare përballet me vonesa, nëntë vende të B...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.